

Afikset në Esperanto

Sistemi i afikseve (i parashtesave dhe i prapashtesave) të Esperantos është një nga shpikjet më të mëdha të Zamenhofit.

Me anë të afikseve- dhjetë parashtesa, dyzetë prapashtesa teknike dhe jo zyrtare- Esperanto ka një mjet të shquar për ta thjeshtuar për nxënësin sasinë e fjalëve për t'u mbajtur mend.

Si mund ta ilustrojmë këtë?

Le të krahasojmë dy situata, të atij që nis të mësojë Esperanton dhe të atij që nis të mësojë anglishten si një gjuhë të dytë të huaj.

Ta zemë se ai i ka mësuar elementët kryesorë të morfologjisë të gjuhës; nxënësi i Esperantos i zotëron afikset dhe mënyrën e përdorimit të tyre.

Ai mëson psh një fjalë të re, foljen **manĝi** (me ngrënë). Ai e di që kjo fjalë përbëhet nga rrënja **manĝ** dhe mbaresa foljore i. (për paskajoren). Menjëherë ai mund të krijojë një masë fjalësh të tjera me rrënjën manĝ, kuptimin e të cilave ai mund edhe të mos e mësojë, falë lidhjeve të rregullta ndërmjet tyre.

Veprimin e ngënies mund ta quajë **manĝo**, atë që hamë (ushqimin)e quan **manĝaĵo**.

Nxënësi tjetër që mëson anglishten nisët nga fjala **to eat**

Por ai duhet të mësojë një fjalë të re për veprimin e të ngrënit, **a meal** dhe një fjalë për atë që hamë **food**.

Këto nuk janë rrjedhime të rregullta që krijohen nga folja to eat, por forma krejt arbitrare. Prandaj duhen mësuar përmëndësh veçan..

Veprimi i përsëritur në Esperanto dhe anglisht nuk përbën problem, **manĝado** dhe **eating**.

Esperantisti i ri vazhdon me fjalët **manĝejo** (mensë), **manĝujo** (ena e gjellës), **manĝilaro** (mjetet e ngrënies). Ndërsa nxënësi i anglishtes djersin për të mbajtur mend **dining-hall** ose **canteen**, **manger**, **cutlery**, **crockery**.

Për esperantistin diçka mund të jetë **manĝebla**, (e ngrënëshme) **manĝinda** (ia vlen për t'u ngrënë) ose edhe **manĝenda** (që duhet ngrënë).

Në anglisht janë fjalët **eatable** dhe **edible**. Asnjë fjalë për **manĝinda**. Mund ta krijojë vetë **eatingwarth**, por kjo nuk ekziston në fjalor.

Për fjalën **manĝema** (llupës) kemi vetëm formën pa lidhje **hungry**.

Çdo folës i Esperantos mund të vazhdojë: **manĝeto** (ngrënie e vogël), **manĝeti** (ha pak), **manĝegi** (ha shumë), **manĝaĉi** (ha keq).

Në anglisht duhen mbajtur mend katër fjalë të reja **a snack, to nobble, to eat heartily, to guzzle.**

Pastaj vjen deti i idiomave, që nga **a square meal** deri te **to fall to, to tuck in** dhe **to do justice to.** (me ra në të, me u palos, me ba drejtësi), që të gjitha sinonime të fjalës mançi.

Po japim një shembull se si nga një rrënjë mund të krijohen shumë fjalë të reja:

Rrënja san- shëndet

Sano	Shëndet	Malsani	Me qenë i sëmurë
Sana	I shëndetshëm	Malsanulo	Njeri i sëmurë
Sane	Shëndetshëm	Malsaniga	Sëmurëse
Sani	Me qenë i shëndetshëm	Malsaniçi	Me u sëmur
Sanu	Ji i shëndetshëm	Malsaneta	Pakëz i sëmurë
Saniga	Shëndetsues	Malsanema	I prirë për sëmundje
Saneco	Të qëniti i shëndetshëm	Malsanulejo	Sëmundjetore- spital
Sanilo	Mjet shëndeti	Malsanulisto	Punëtor i sëmundjetores
Sanigi	Shëndetsoj	Malsanero	Element sëmundjeje
Saniçi	Shëndetsohem	Malsaneraro	Elementët e sëmundjes
Sanejo	Vend shëndeti	Sanigebla	Shëndetsuese
Sanisto	Shëndetsues	Sanigisto	Shëndetsues
Sanulo	Njeri i shëndetshëm	Sanigilo	Mjet shëndetsues
Malsano	Sëmundje	Resanigi	Me shëndetsue
Malsana	I sëmurë	Resaniçanto	I shëndetsuar
Malsane	Sëmurë	Sanigilejo	Vendi i mjeteve shëndetsuese

Sanigejo	Vend shëndetsimi	Saniginda	Ia vlen ta shërosh
Malsanemulo	Njeri i prirë për t'u sëmurur	Sanilujo	Vendi i mjeteve të shëndetit
Sanilaro	Mjetet e shëndetit	Sanigilujo	Vendi i mjeteve shëndetsuese
Malsanaro	Sëmundjet	Remalsano	Risëmundje
Malsanulido	Fëmijë i të sëmurit	Remalsaniço	Risëmurje
Nesana	Jo i shëndetshëm	Malsanulino	Femër e sëmurë
Malsanado	Sëmundësimi	Sanigista	E shëndetsuesit
Sanulaço	Diçka për njeriun e shëndetshëm	Saniligista	E bërësit të mjeteve shëndetsuese
Malsaneco	Sëmundësi	Sanilista	E bërësit të mjeteve të shëndetit
Malsanemeco	Sëmundshmëri	Malsanulista	E sëmundjebërësit

